



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 6-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.06.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Rasim Hasani, DKA
3. Safet Krasniqi, Auditor i Brendshëm

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë, po ashtu tha se pikën e 3-të të rendit të ditës do ta heqim dhe do ta caktojmë për seancën e ardhshme.

Latif Ramadani, tha se këtë pikë do ta keni në seancën ardhshme për shkak të disa gabimeve teknike nga departamenti i financave i Ministrisë së Financave, poashtu për shkak se me ridestitim nuk na është lejuar asnjë projekt i ri.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 5-të e KPF-së.

2. Propozim Vendim mbi aprovimin e kornizës afatmesme buxhetore 2023-2025.

3. Propozimi Vendim mbi caktimin tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në Qendrën për edukim dhe arsimim parashkollor në Lipjan.

4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2021.

5. Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës, për vitin 2021, në të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 6 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj Kryesuesi tha se pikën e 4-të dhe të 5-të a jeni që të kalojnë direkt në Kuvend?

Me të gjitha votat, 6 për, u aprovua propozimi.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 5-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 6 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 5-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Arsim Jashari, tha se i kam parë edhe propozimet e mëhershme të buxhetit dhe ka disa projekte të cilat kanë qenë të projektuara edhe vitet e kaluara por nuk janë realizuar siç janë kabinetet etj.

Latif Ramadani, tha se këto kanë qenë projekte dy-tri vjeçare të cilat mund të zgjasin por ka edhe projekte të cilat do të përfundojnë me bashkë financim.

Alban Salihu, tha se të shkolla e Banullës dhe e Dobrajës është ndarë një shumë e mjeteve për rregullimin e shkollave , nuk e di a do të mjaftojnë këto mjete?

Latif Ramadani, tha se bëhet fjalë për shkollën e vogël dhe ato besoj që mjaftojnë.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozimi Vendim mbi caktimin tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në Qendrën për edukim dhe arsimim parashkollor në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Alban Salihu, tha se për mendimin tim është e paarsyeshme rritja e çmimit në këtë kohë kur dihet se çdo çmim thuhet se është rritur dhe është mirë Komuna të gjejë një burim financiar sa i përket kësaj çështje. Dhe, ne jemi kundër.

Arsim Jashari, tha se edhe mua më duket e paarsyeshme rritja e çmimit në këtë kohë pasi që pagat nuk kanë lëvizur , dhe tani nuk është koha e duhur që çmimet të rriten.

Rasim Hasani, tha se çdo lëvizje e çmimit nuk është e favorshme dhe nuk pritet mirë por në çerdhe dërgohen fëmijët të cilëve janë të punësuar të dy prindërit dhe tani janë rritur çmimet të cilat çerdhja nuk mund t'i përballoj dhe kjo është njëra ndër arsyt .Komuna në kohën e pandemisë edhe i ka liruar nga pagesa çerdhet.

Arsim Jashari, tha se nuk është koha e duhur që këto çmime të rriten tani.

Alban Salihu, tha se dhe unë pajtohem që nuk është momenti i duhur që këto çmime të rriten.

Daut Azemi, tha se saherë që rriten çmimet nuk priten mirë nga qytetarët por është e nevojshme pasi që çdo ditë e më shumë po rriten nevojat edhe në çerdhe po ashtu edhe çmimet e kanë bërë të vetën.

Rasim Hasani, tha se unë pres që ju ta përkrahni këtë propozim pasi që është nevojë që ky çmim të rritet.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi